



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

## Komunikatë

**19.07.2013**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbajti mbledhjen e 37-të në të cilën, shqyrtoi disa nga prioritetet që lidhen me përgatitjet dhe zbatimin e operacioneve zgjedhore.

Kryeshefi i SKQZ-së, Enis Halimi e njoftoi KQZ-në për aktivitetet që janë në zhvillim e sipër lidhur me përgatitjet e zgjedhjeve të 3 lokale të nëntorit. Sipas tij, është bërë emërimi i anëtarëve të KKZ-ve për të gjitha komunat, dhe është hartuar drafti plani operacional i Sigurisë për Zgjedhjet Lokale 2013. Periudha e Shërbimit të Votuesve për Ndërrimin e Qendrës së Votimit. Kurse, në kuadër të përgatitjeve për Operacionin e Votimit përmes Postës, janë përgatitur edhe formularët për regjistrim me informatat e duhura. Ndërsa, për Linjat telefonike që do të shërbejnë si linja ndihmëse për votuesit jashtë Kosovës, është dërguar kërkesa për linjat telefonike që do të kenë qasje ndërkombëtare, gjithashtu është bërë kërkesa për aktivizimin e postës elektronike (e-mail) që shërbejnë gjatë periudhës së regjistrimit dhe periudhës së votimit në kuadër të Operacionit të Votimit përmes Postës. Në bazën e të dhënave, është bërë verifikimi i të dhënave për anëtarë të KKZ-së në bazë të ligjit. Në fushën e Dizajnit, janë përgatitur Drafti dizajni i Fletëvotimit (model) për Kryetar Komune për Raundin 1, dhe 2 për Zgjedhje Lokale; Drafti dizajni i Fletëvotimit (model) për Kuvend Komunal në formatin A4, dhe A3; Draftimi final i Specifikave teknike për Shtypjen, Paketimin dhe Transportin e Fletëvotimeve dhe të Broshurave; Freskimi i Uebfaqes me rreth 40 materiale të ndryshme (Lajme, vendime, publikime) në tri gjuhë; Dizajnimi i vizitkartave për anëtarët e KQZ-së, dhe anëtarët e Menaxhmentit. Në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve (QNR), janë zhvilluar aktivitetet, si: miratimi i Planit Operacional të QNR-së nga KQZ, përgatitja e specifikave për material zgjedhor, specifikat për riparimin e gjeneratorëve në QNR; Koordinatori i QNR-së, është në fazën e përgatitjes së Draftprojektit “K-Vote” - Rezultatet Preliminare i cili, do të shqyrtohet në KOZ, si dhe po përgatitjen specifikat për Softuerin e QNR –së, dhe po përgatitet Organogrami për stafin e QNR-së.

Kryesuesi i Këshillit për Operacione Zgjedhore, Alban Krasniqi, tha se janë shqyrtuar dy kërkesa për zëvendësime nga komuna e Vushtrrisë. KQZ, mori vendim për emërimin e Abdullah Vojvodës, për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i cili e zëvendësoi anëtarin e deritashëm, Gani Imeri. KQZ, mori vendim për emërimin e Nasuf Aliut, anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga subjekti politik “Aleanca për Kosovën e Re” (AKR), i cili e zëvendësoi anëtarin e deritashëm, Tasim Gubetini.

Në vazhdim, u shqyrtuan edhe nominimet për anëtar të KKZ-ve për koalicionin Kosova e Re. Kryesuesi i KOZ-it, Alban Krasniqi, tha se është shikuar lista e nominimeve, kriteret ligjore dhe një person është kërkuar që të hiqet sepse, nuk i përket subjektit përkatës. Sipas kësaj liste, janë edhe dy nominime për subjektin politik “KDTP” dhe “PDAK”, nga komuna e Lipjanit, dhe nga subjekti PDAK në Suharekë.

Pas shqyrtimit, KQZ, miratoi nominimet e koalicionit “Kosova e Re”, si dhe miratoi edhe nominimet e KDTP-së, dhe të PDAK-së. Alban Krasniqi, e informoi KQZ-në lidhur me procedimin e këtyre nominimeve. Pas gjithë procesimit të materialit, si rezultat edhe i shqyrtimeve edhe të mëhershme, dhe renditja në Mitrovicën e veriut është bërë normalisht, si edhe për komunat e tjera. Janë 10 vende, dhe 11. Rënditja, është kjo: SLS, PDK, LDK, AAK dhe Vetëvendosja. Për tri komunat e tjera, është bërë hedhja e shortit për renditje si mënyra më e lehtë, më transparente. Ka dalë kjo renditje: komuna e Leposaviqit: SLS, LDK, Vetëvendosje, në Zubin Potok: SLS, PDK dhe AAK, në Zveçan: SLS, PDK dhe AAK. KQZ, i shqyrtoi dhe i miratoi nominimet për vendet e rezervuara për katër komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë.

Illir Gashi, kryesues Këshilli për Buxhet dhe Prokurim, e informoi KQZ për takimin e fundit të këshillit dhe tha se, është hartuar plani i Buxhetit të Prokurimit. Debati në këtë pike të rendit të ditës, u fokusua lidhur me kërkesën për harmonizimin e pagave, lidhur me procesin zgjedhor etj. Në debat, u angazhuan Florian Dushi, Betim Gjoshi, Nexhmi Haxhiu, Miradije Meha, Valdete Daka, Binak Vishaj, Alban Krasniqi.

Në këtë mbledhje, anëtarët e KQZ i kërkuan Sekretariatit që, të hartojë një listë në të cilën, do të evidentohet pjesëmarrja e KKZ-ve në punë, si dhe kërkoi nga KZZ-të të raportojnë në SKQZ çdo javë lidhur me punën që bëjnë, në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet. KQZ, kërkoi nga kryetarja dhe anëtarët e KQZ-së që, secili anëtarë i cili zhvillon takime zyrtare në emër të KQZ-së, duhet t’i njoftoj anëtarët e KQZ-së gjatë mbledhjeve.

#### **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**